



Java e Gruas 2024: Konferenca Hyrëse

Udhëhiq me Gjithëpërfshirje: Ndërthurja e Politikës me Ekonominë

Java e Gruas (WoW) është një ngjarje vjetore mbarëkombëtare që mbledh në një mjedis ndëretnik, më shumë se 120 gra dhe burra nga partitë politike, shoqëria civile, biznesi, media dhe academia, me qëllim të zgjerimit dhe forcimit të shkathtësive të grave udhëheqëse dhe mbështetjes së tyre për të marrë pozicione të larta drejtuese. Gjatë dymbëdhjetë viteve të fundit, WoW ka ofruar një platformë për dialog mbi politika dhe diskutim intensiv me liderë politikë dhe zyrtarë të zgjedhur, duke u mundësuar pjesëmarrësve t'i mbajnë përgjegjësi përfaqësuesit e tyre dhe në të njëjtën kohë të mbështesin zhvillimin e shkathtësive për gratë në leadership në politikë.

“Udhëhiq me Gjithëpërfshirje: Ndërthurja e Politikës me Ekonominë” do të fokusohet në domosdoshmërinë për ndërthurjen në mes të leadershipit gjithëpërfshirës, politikës dhe ekonomisë, dhe ndikimin e tyre në formimin e shoqërive të shëndosha. Udhëheqja gjithëpërfshirëse është çelësi për sigurimin e kohezionit social, rritjes ekonomike dhe forcimin e qeverisjes demokratike. Tema kryesore e Javës së Gruas 2024 synon që përmes sesioneve të ndryshme të sjellë një dialog të hapur që vë në pah praktikatat dhe përfitimet e të udhëhequrit me gjithëpërfshirje, si një parim fundamental qeverisjeje që merr parasysh nevojat e individëve dhe grupeve të ndryshme të shoqërisë, duke përfshirë pikëpamjet e grave, komuniteteve jo shumicë, të rinjve, personave me aftësi të kufizuara, LGBTQI+ dhe grupe të tjera të nënpërfaqësuar.

Java e Gruas organizohet nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI) me mbështetjen e Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). NDI gjithashtu falenderon Ambasadën e Kanadasë në Kroaci dhe Kosovë për mbështetjen e Javës së Gruas 2024.

Dita 1

9:00- 9:40 Arritja e pjesëmarrësve

10:00 - 10:05 Fjalë mirëseardhëse

- Ambasadorja Nancy Soderberg, Drejtore e Zyrës, NDI Kosovë

10:05-10:15 Fjalët hyrëse

- Kerry Monaghan-Hogler, U.d. Udhëheqëse e Misionit, USAID Kosovë
- Beate Katja Elsässer, Udhëheqëse e Zyrës për Bashkëpunim, Ambasada e Zvicrës, Kosovë

10:15 - 10:25 Adresim kryesor: Avansimi i leadershipit gjithëpërfshirës si domosdoshmëri strategjike në adresimin e sfidave të shekullit 21

- Shkëlqesia e saj, Dr. Vjosa Osmani Sadriu, Presidente e Republikës së Kosovës



- Dr. Geeta Rao Gupta, Ambasadore e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Çështje Globale të Grave (video mesazh)

10:25-10:55 Fuqia e Veprimit: Si luftohet pabarazia gjinore përmes lidërshiptit gjithëpërfshirës?

Pabarazia në nivel global, ku Kosova nuk përbën përjashtim, manifestohet në forma të ndryshme dhe shtrihet në dimensione ekonomike, politike dhe sociale. Komunitetet e nënpërfaqësuar, me theks të veçantë gratë, bartin peshën kryesore të pabarazisë në shoqëri, duke u përballur me diskriminim ekonomik dhe përjashtim nga proceset vendimmarrëse. Gjithëpërfshirja si parim kyç në udhëheqje siguron përfaqësimin e individëve dhe grupeve të ndryshme të shoqërisë, adreson nevojat dhe prioritetet e tyre me qëllimin përfundimtar të arritjes së barazisë sociale.

- Gresa Caka Nimani, Kryetare, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës

11:00-12:30 Panel diskutimi: Fuqizimi ekonomik si parakusht për ndërprerjen e ciklit të dhunës

Dhuna me bazë gjinore dhe dhuna ndaj grave mbeten sfida globale, të cilat përbëjnë një nga pengesat kryesore drejt arritjes së barazisë gjinore. Ndonëse si fenomen prekë të gjitha gratë pa dallim, gratë që kanë pozitë më të pafavorshme financiare janë më të rrezikuara të mbesin më gjatë në ciklin e dhunës. Ky panel diskutimi synon të vë në pah se si politikëbërja bazuar në identitetet ndërthurëse ndikon në fuqizimin ekonomik të grave, ofron zgjidhje të qëndrueshme për ndërprerjen e ciklit të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës ndaj grave.

- Jeta Statovci, Deputete, Zëvendëskryetare e Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi, dhe Tregti, Kuvendi i Republikës së Kosovës
- Blerta Deliu-Kodra, Deputete, Anëtare e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, Kuvendi i Republikës së Kosovës
- Hykmete Bajrami, Deputete, Kryetare e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, Kuvendi i Republikës së Kosovës
- Arbërie Nagavci, Ministre e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Qeveria e Republikës së Kosovës
- Saxhide Mustafa, Koordinatorë, Forumi Ekonomik i Grave

Moderator: Isak Skenderi, Drejtor Ekzekutiv, Zëri i Romëve, Ashkalive, dhe Egjipstasve, VORAE

12:30 - 13:30 Dreka

13:30 - 14:15 Diversifikimi i përfaqësimit: Gjinia, politika dhe ekonomia

Diskutim i hapur me Lumir Abdixhiku, Kryetar, Lidhja Demokratike e Kosovës

Lidërshipti gjithëpërfshirës në partitë politike ngërthen perspektivat dhe përvojat e ndryshme të shoqërisë. Duke siguruar që strukturat dhe platformat politike të partive pasqyrojnë diversitetin shoqëror, mundësohet një peisazh politik më gjithëpërfshirës, hartohen politika që u përgjigjen direkt nevojave të individëve dhe grupeve pa dallim gjinor, përkatësi etnike, orientimin seksual, statusin e tyre socio-ekonomik dhe dimensione të tjera të identitetit. Në këtë sesion, pjesëmarrësit do të kenë mundësinë



të diskutojnë lidhur me strategjitë dhe politikat kyçe që partitë politike mund të ndërmarrin për ofrim të mundësive të barabarta për të gjithë pa dallim.

Moderatore: Lirika Haliti-Istrefi, Redaktore, KlanKosova

14:15 - 14:30 Pushimi i kafes

14:30-15:30 Sesione në grupe: Rritja e pjesëmarrjes kuptimplotë në jetën publike

Grupi A: Zbatimi i një qasje praktike drejtë pavarësisë ekonomike

- Laura Nichols, Eksperte e Partive Politike dhe Fuqizimit të Grave

Grupi B: Përdorimi i intelegjencës artificiale për avansim profesional

- Teresa Crawford, Kryetare e Bordit, IPKO Foundation

15:30 Nisja

Dita 2

10:00 - 10:05 Fjalë mirëseardhëse

- Pranvera Lipovica, Drejtore e Programit, NDI Kosovë

10:05 - 10:10 Fjalë hyrëse

- Nathalie Niedoba, Zëvendës Udhëheqëse e Misionit dhe Konsulle, Ambasada e Kanadasë në Kroaci dhe Kosovë

10:10 - 10:15 Adresim kryesor: Avokimi për barazi ekonomike përmes ndërthurjes së identiteteve

- Katrin Langensiepen, Deputete, Parlamenti Evropian (video mesazh)

10:15-11:00 Udhëhiq me gjithëpërfshirje: Pse duhet të jetë e vëmendshme Qeveria?

Diskutim i hapur me Emilija Redžepi, Zëvendëskryeministre e tretë për Çështje të Pakicave dhe Drejtat e Njeriut, Republika e Kosovës

Udhëheqja me gjithëpërfshirje siguron stabilitet politik, ekonomik dhe një demokraci të qëndrueshme. Individë dhe grupe të shumta në shoqëri, veçanërisht gratë, personat me aftësi të kufizuara, personat LGBTQI+ dhe komunitetet joshumicë, përballen me barriera të vazhdueshme sistemike që pengojnë qasjen e barabartë në mundësitë ekonomike dhe politike. Në këtë sesion, pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të diskutojnë lidhur me gjithëpërfshirjen si parim qeverisës për hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe politikave si mënyrë për të këputur zingjirin e praktikave dhe barrierave diskriminuese dhe dekurajuese, kështu duke mundësuar qasje të barabartë për angazhim kuptimplotë të qytetarëve në shoqëri.

Moderator: Bujar Kadriu, Drejtor Ekzekutiv, Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar



11:00 - 12:30 Panel Diskutimi: “Qytetet me ndjeshmëri gjinore: Alternativa gjithëpërfshirëse me bazë në komunitet”

Një qytet me ndjeshmëri gjinore njeh dhe përfshinë nevojat unike të individëve dhe komuniteteve për të ofruar hapësira të jetueshme, të sigurta dhe të qasshme për të gjithë. Angazhimi aktiv i qytetarëve në proceset e politikëbërjes në nivel lokal është pikënisje për të promovuar ndryshimet pozitive dhe përmirësuar kualitetin e jetës së tyre. Ky panel diskutimi synon të adresoj rëndësinë e përfaqësimit përmes integritit të perspektivës të ndjeshme gjinore në qeverisje lokale, për të siguruar një ambient më gjithëpërfshirës dhe fuqizues ku të gjithë qytetarët të mund të veprojnë dhe lëvizin pa paragjykim, frikë dhe vështirësi për ndërveprim në jetën publike.

Adresim kryesor: Ambasadorja Nina Hachigian, Përfaqësuesja Speciale e SHBA-ve për Diplomacinë e Qytetit dhe Shtetit (video mesazh)

- Eliza Hoxha, Deputete, Kuvendi i Republikës së Kosovës
- Kadri Rahimaj, Kryetar, Komuna e Kamenicës
- Arjeta Skeraj, Kryesuese e Kuvendit, Komuna e Dragashit
- Burbuqe Bakija Deva, Anëtare e Kryesisë, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
- Sazan Ibrahim, Drejtor Ekzekutiv, Asociacioni i Komunave të Kosovës

Moderatore: Alexandra Jovanović, Gazetare, RTK2

12:30 - 13:00 Fuqia e Veprimit: Nxitja e ndryshimit përmes aktivizmit politik

Aktivizmi politik është një nga mjetet më të fuqishme të promovimit të ndryshimeve që sjellin barazi sociale dhe garantojnë të drejtat themelore të njeriut. Individët dhe aktivistët e komunitetit LGBTQI+ historikisht kanë luajtur rol qëndror në lëvizje më të gjera për drejtësi sociale dhe të drejtat e njeriut, duke vënë në pah ndërthurjen e sfidave dhe përballjen në betejat kundër diskriminimit, kështu duke u pozicionuar në krye të avokimit për ndryshim të politikave me rëndësi qenësore për formimin e një shoqërie të hapur, të drejtë dhe të barabartë.

- Blert Morina, Drejtor Ekzekutiv, CEL Kosova

13:00 - 14:00 Dreka

14:00 - 15:00 Sesione në grupe: Rritja e pjesëmarrjes kuptimplotë në jetën publike

Grupi A: Përdorimi i intelgjencës artificiale për avansim profesional

- Teresa Crawford, Kryetare e Bordit, IPKO Foundation

Grupi B: Zbatimi i një qasje praktike drejtë pavarësisë ekonomike

- Laura Nichols, Eksperte e Partive Politike dhe Fuqizimit të Grave



15:00 - 15:15 Fjalët përmbyllëse

- Ambasadorja Nancy Soderberg, Drejtore, NDI Kosovë
- **15:15** Nisja